



CSX.0238

CONSILEX BARRIER CREAM

Xhel hidroizolues prej silani, me qese prej 600 cm², për barriera kimike

Kodi doganor

3824 9970

Amballazhimi

- Fishek 600 cc
- Kuti: 10 x (Fishek 600 cc)

Aplikimi

- Pistoletë me dozë të përcaktuar

Familja
Consilex

Tipologjia
Tretësira ujore silani ose siloksani

Linjat e produkteve
• Building
• Opus

Kategoritë e përdorimit
• Hidroizolimin i muraturave përmes mbylljes së rrjedhjeve kapilare

Përbërësit
Monokomponent

Paraqitja
Lëng i trashë

Përshkrimi i produktit

Agjent mbushës me bazë silani që shërben për formimin e barrierave kimike kundër përhapjes kapilare të lagështirësë, veçanërisht i përshtatshëm për muratura të reja, gjithashtu dhe për porozitetin (tulla refraktore, dyfishe, etj.). Tregëtohet në qese të veshura me alumin prej 600 cm² (fishek "i butë"), që futet pastaj në pistoletën e posaçme për izolime me fishekë.

Të dhëna shtesë

CONSILEX BARRIER CREAM është një xhel i përqëndruar, me bazë silani, i formuluar posaçërisht për injeksione murale me qëllim formimin e barrierave kimike me efektivitet të lartë, kundrejt përhapjes kapilare të lagështirësë.

Produkti mund të gjejë shumë mirë përdorim në mure të ngurtë (gurë, tulla, shtuf, gurë ranor, beton), por gjithashtu mund të përdoret në mënyrë efektive në blloqet e tulla me vrimë (muraturë poroze).

Xheli depërton dhe përhapet në mënyrë të përsosur, duke formuar një barriera të qëndrueshme kimike, duke parandaluar kështu për disa vite depërtimin e lagështisë përmes kapitalereve në porozitetin e murit. CONSILEX BARRIER CREAM gjithashtu lufton formimin e mykut në muraturë dhe nuk ndryshon aspak avullimin e shtresës mbështetëse. Produkti tregëtohet me qese prej 600 cm² të veshura me alumin.

Konsumi

Përafërsisht 200 cc CONSILEX BARRIER CREAM për metër linear të mureve 10 cm të trasha. Llogaritni konsumin në raport me trashësinë e muraturës që do të restaurohet.

Fushat e përdorimit

Ndalimi i depërtimit të lagështisë përmes kapilareve në muret thithëse me tulla të përziera, gurë, shtuf dhe gjithashtu me tulla me vrima, në ndërtesat e reja dhe të vjetra urbane, rurale, historike dhe monumentale.

Vetitë kryesore



I pandezshëm



Jetëgjatësia:
12 muaj



Temperatura e aplikimit:
+8 / +35 °C



Ngjyrat në dispozicion
E bardhë

Veçoritë teknike

pH: 7 _

Mjetet e pastrimit

- Ujë

Shtresat e lejuara

- Beton
- Tulla
- Shtuf
- Muratura të përziera
- Muratura me tulla me vrimë
- Muratura me gurë

IF YOU WANT TO SOLVE IT


www.azichem.com

Përditësimi më: 25/08/2020
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer

Përgatitja e shtresave (mbështetëse)

Vizatoni një vijë paralele me trotuarin e jashtëm ose dyshtemenë e brendshme, në një distancë prej rreth 12-15 cm njëra nga tjetra. Në vijën e hequr, vendos pikat e shpimit me 12 deri 15 cm larg njëri-tjetrit. Pjerrësia e vrimave mund të jetë nga 0° (horizontale) deri 20° për poshtë. Thellësia e vrimave do të jetë rreth 2/3 e trashësisë së murit që do të trajtohet. Maja e trapanit që do të përdoret duhet të ketë një diametër prej 12-14 mm. Pasi të jenë përfunduar vrimat, duhet të pastrohet pluhuri i prodhuar nga vrimat..

Mënyra e përdorimit

CONSILEX BARRIER CREAM duhet të injektohet në mur përmes një pistolette të posaçme për qese prej 600 cm² ose ml (të tipit më të përdorshëm për izolime dhe mastiçe), si manuale ashtu edhe automatike, sipas rradhës së mëposhtme:

Fusni qesen në vendin e caktuar të pistoletës dhe hiqni mbyllësen prej metali të qeses.

Vendosini pistoletën tubin e vogël që ndodhet në ambalazh (në vend të grykës plastike) Shtydhjeni CONSILEX BARRIER CREAM në vrimat me një sasi prej 20-25 ml per cm të murit ku injektohet, për çdo metër linear. Shembull: për një mur prej 40 cm, do të duhet 1 litër për metër të CONSILEX BARRIER CREAM (25 ml/cm x 40 cm = 1000 ml për metër).

Pasi të keni mbaruar injeksion dhe të keni mbyllur vrimat (me llaç çimentoje ose gëlqere), pas disa ditësh duhet përgjithësisht të hiqet suvaja në mënyrë që të lejojë një tharje sa më të mirë të murit të trajtuar.

Së fundmi, pas tharjes së plotë të murit pa suva, ai duhet të suvatohet përsëri, mundësisht me suva hidroizolimi makroporoz (SANATIGH).

Konsumi i paraqitur duhet të konsiderohet thjesht si orientues, sasia e saktë që duhet përdorur duhet të përcaktohet gjithmonë përmes provave paraprake të përshtatshme, veçanërisht në rastin e mureve me tulla me vrima.

Magaznimi e Ruajtja

Ruhet nga ngrica. Ruajeni produktin në ambalazhimin origjinal, në një mjedis të freskët dhe të thatë, duke shmangur acarin dhe rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Ruajtja e papërshtatshme e produktit mund të shkaktojë humbje të vetive reologjike. Qeset e hapura duhet të përdoren menjëherë.



Paralajmërimi, Masa paraprake, Ekologji

Të dhënat e përgjithshme, ashtu si dhe indikacionet dhe sugjerimet për përdorimin e këtij produkti, të paraqitura në këtë fletë teknike të të dhënave dhe mundësisht të shpjeguara dhe me gojë ose me shkrim, përputhen me gjendjen aktuale të njohurive tona shkencore dhe praktike.

Të dhënat teknike dhe të performancës të paraqitura janë rezultat i provave laboratorike të kryera në një mjedis të kontrolluar dhe si të tilla mund të ndryshojnë në lidhje me kushtet e vënies në funksionim.

Azichem Srl nuk merr asnjë përgjegjësi që rrjedhin nga performanca jo e duhur që ka lidhje me përdorimin jashtë rregullave të produktit, ose që ka lidhje me defektet që rrjedhin nga faktorë ose elementë që nuk kanë lidhje me cilësinë e produktit, duke përfshirë këtu dhe konservimin e pasaktë.

Kushdo që synon të përdorë produktin duhet të vendosë, para përdorimit, nëse është i përshtatshëm për përdorimin e synuar, duke marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë e tij.

Karakteristikat teknike dhe të performancës të përfshira në këtë fletë të dhënash teknike përditësohen në mënyrë periodike. Për një konsultë në kohë reale lidhuni me sitin: www.azichem.com. Data e rishikimit paraqitet në cep të produktit. Ky njoftim anulon dhe zëvendëson çdo njoftim tjetër të mëparshëm.

Mos harroni se përdoruesi është i detyruar të lexojë Fletën më të fundit të të Dhënave të Sigurisë së këtij produkti, që përmban të dhëna kimike-fizike dhe toksikologjike, parashikimet e rrezikut dhe informacione të tjera me qëllim që të transportojë, përdorë dhe asgjësojë produktin dhe paketimin e tij me siguri të plotë. Për konsultim lidhuni me sitin: www.azichem.com.

Ndalohet hedhja e produktit dhe / ose amballazhit të tij në mjedis.

CONSILEX BARRIER CREAM prodhohet/shpërndahet nga



Via Giovanni Gentile, 16/A - 46044 Goito (MN), Itali
info@azichem.com Tel. +39 0376.604185 /604365 Fax +39 0376 604398



www.azichem.com

Përditësimi më: **25/08/2020**
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer